

# Si raportohet dhuna me bazë gjinore: Hapat kryesorë

**Dhuna mund të raportohet nga viktimat, fëmijët, profesionistët ose çdo person që ka dijeni për rastin. Raportimi është i lirë, falas dhe pa formalitete të ndërlikuara.**

## 1 IDENTIFIKIMI I DHUNËS

Dhuna nuk është vetëm fizike; ajo mund të jetë psikologjike, seksuale, ekonomike ose e ushtruar përmes teknologjisë dhe mund të ndodhë në familje, në marrëdhënie intime, në vendin e punës, në komunitet ose në mjediset online.



## 2 RAPORTIMI I RASTIT

Rasti mund të raportohet menjëherë pranë:

- Policisë së Shtetit
- Bashkisë (Mekanizmi i Koordinuar i Referimit)
- Qendrës shëndetësore
- Shërbimeve sociale
- Qendrave/strehëzave për viktimat
- OJF-ve të specializuara



## 3 VLERËSIMI I RREZIKUT DHE MASAT URGJENTE

Autoritetet bëjnë vlerësimin e menjëhershëm të rrezikut dhe marrin masa për sigurinë e viktimës, përfshirë mbrojtjen urgjente dhe ndalimin e dhunës.



## 4 REFERIMI PËR MBËSHTETJE

Në bazë të nevojave të evidentuara, viktimat drejtohen drejt shërbimeve të duhura mbështetëse dhe të specializuara, për të siguruar mbrojtje, ndihmë dhe rehabilitim.



## 5 MBROJTJA LIGJORE DHE NDJEKJA E RASTIT

Viktima mund të kërkojë urdher mbrojtjeje në gjykatë dhe mbështetet me këshillim dhe ndihmë ligjore gjatë gjithë procesit.